



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ____/____/2026

VENDIM

Nr. 6, datë 19.03.2026

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT MBI REALIZIMIN E BUXHETIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR VITIN FINANCIAR TË MBYLLUR NË 31 DHJETOR 2025”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “I”, nenit 62 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 4, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 20, pika 5 dhe pika 6 i Rregullores nr. 34, datë 27.11.2020 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31 datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, zëvendës drejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitin financiar të mbyllur në 31 Dhjetor 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

